



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.72/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër Samostalna Liberalna Stranka(SLS) dhe Progresivna Demokratska Stranka(PDS) me seli në Graçanicë, për shkak të vendosjes se posterit në objekte publike dhe shtyllë publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, kështu që subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka(SLS), me seli në Graçanicë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,400.00 (njëmijë e katërqind) euro, dhe subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka(PDS), me seli në Graçanicë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,400.00 (njëmijë e katërqind) euro.

II. Subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka(SLS) dhe subjekti politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS), **detyrohen** ti paguajnë gjobat e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 05.06.2017 nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017, ka vërejtur se në rrugën kryesore në qytetësen e Graçanicës në rrugën Minatori, monitoruesi e ynë ka hasur në postier e kandidatit për deputet nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka(SLS) dhe Progresivna Demokratska Stranka(PDS), të vendosur në objekte publike gjegjësisht në transformator të energjisë elektrike dhe shtyllë publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1,pika b), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr.03/L-073 duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkel këto nene në momentin që ka vendosur posterin në hapësirë publike. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur CD dhe 1(një) fotografën të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të subjektit politik Liberalna Stranka(SLS) dhe Progresivna Daemokratska Stranka(PDS), të datës 06.06.2017 thekson se nga përgjigja e ofruar nga PDS-ja mund të shihet se PDS me një njoftim zyrtar i ka njoftuar anëtarët, simpatizantët dhe kandidatët e vetë me Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike dhe kandidatet e tyre. Në

këtë njoftim i cili është protokolluar me nr. 25/2017 të datës 24.05.2017 në librin e protokollit të PDS-së theksohen dhe parashihen të gjitha veprimet e ndaluara për anëtarët, simpatizantët dhe kandidatët e PDS-së gjatë procesit zgjedhor.

Në fund të njoftimit theksohet se PDS-ja publikisht dhe seriozisht i gjykon anëtarët, simpatizantët dhe kandidatët e saj për çdo shkëlje të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes dhe rregullave në fuqi që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

Si dëshmi janë bashkangjitur edhe 2(dy) fotografi nga vendi i ngjarjes ku shihet se janë ndërmarr masat korrektuese për evitimin e shkëljes së bërë. Ndërsa subjekti politik(SLS) ne përgjigje në ankesë ka bashkangjitur vetëm 1(një) fotografi, pa shprehur ndonjë arsytim.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se postieri i kandidatit për deputet në fushatën zgjedhore i Samostalna Liberalna Stranka(SLS) dhe Progresivna Demokratska Stranka(PDS), është vendosur në rrugë publike e cilat shfrytëzohen për shërbime publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LPZ-së e cila përcakton *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”*

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstatoi se nga provat e ofertuar shihet qartë se nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka(SLS) dhe Progresivna Demokratska Stranka(PDS), është shkelur neni 33,pika b) të LPZ-së pasi që postieri i kandidati për deputet nga subjekti politik janë vendosur ne objektin e hapësirave publike të qytetit .të cilën shkeljen e ka pranuar edhe me Samostalna Liberalna Stranka(SLS) dhe Progresivna Demokratska Stranka(PDS), në përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkëljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkëljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkëlje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka(SLS) dhe Progresivna Demokratska Stranka(PDS), kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti se posteri i kandidatit për deputet nga subjektet në fjalë është vendosur në hapësira publik.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin se koalicioni në fjalë , ia dha mundësin për tu përgjigjur ashtu që në përgjigje e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar si në dispozitivin të këtij vendimi

Nga të dhënat e cekura si më lart Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 72/2017 më datën 07.06.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.